



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:191827
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05452681

C.nr.6980/21

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, duke vendosur në çështjen juridiko-kontestimore të paditëses V. J., N. S., B. V., K. S. dhe Xh. G., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Av. B. P. nga Vushtrria, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë, për kompensimin pagës së trembëdhjetë dhe shpërblimit jubilar dhe shujtave vlera e kontestit 18.350.07 euro, jashtë seance me datë 07.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar Kërkesëpadia së bashku me zgjerimin e saj në kuptimin objektiv, e paditësve V. J. (PK...), N. S. (SC...), B. V. (PK...), K. S. (SC...) dhe Xh. G. (PK...) e parashtruar kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, për shpërblimin e pagës së fundviteve 2018, 2019, 2020, 2021, për shpërblimin e shujtës dhe pagës jubilarë.

DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, drejtoria e përgjithshme e policisë, t'ia paguaj shumën si ne vijim.

Paditesi i parë në emer të page mujore ekuivalente në fund vitit 2018,2019,2020 dhe 2021 t'ia paguaj prej 531.90€ në shumën e përgjithshme në total 2.127.60 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 27.06.2021 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 124.00€ të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit, si dhe në emer të kompensimit të pagës jubilarë për pervojen e punës 20 vjeqare t'ia paguaj 50% të nje pagë baze në shumën prej 235.65 euro.

- Paditesi i dyte në emer të page mujore ekuivalente në fund vitit 2018,2019,2020 dhe 2021 t'ia paguaj prej 359.21€ në shumën e përgjithshme në total 1.436.84 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 27.06.2021 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 124.00€ të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit, si dhe në emer të kompensimit të pagës jubilarë për pervojen e punës 16 vjeqare t'ia paguaj 25% të nje pagë baze në shumën prej 142 euro.

- Paditësi i tretë emer të page mujore ekuivalente në fund vitit 2018,2019,2020 dhe 2021, t'ia paguaj prej 639.60 € në shumën e përgjithshme në total 2.558.40 euro, me kamatë

ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 27.06.2021 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 124.00€ të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit, si dhe në emer të kompensimit të pagës jubilarë për pervojen e punës 20 vjeqare t'ia paguaj 50% të nje pagë baze në shumen prej 235.65 euro

- Padiësi i katërt emer të page mujore ekuivalente në fund vitit 2018,2019,2020 dhe 2021, t'ia paguaj prej 418.70€, në shumën e përgjithshme në total 1.674.80 euro me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 27.06.2021 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 124.00€ të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit, si dhe në emer të kompensimit të pagës jubilarë për pervojen e punës 16 vjeqare t'ia paguaj 25% të nje pagë baze në shumen prej 142 euro.

- Padiësi i pëstë emer të page mujore ekuivalente në fund vitit 2018,2019,2020 dhe 2021, t'ia paguaj prej 667.26 € në shumën e përgjithshme në total 2.669.04 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 27.06.2021 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 124.00€ të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit, si dhe në emer të kompensimit të pagës jubilarë për pervojen e punës 21 vjeqare t'ia paguaj 50% të nje pagë baze në shumen prej 235.65 euro

II. Detyrohet e paditura që padiësve t'ua paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës si dhe shpebzimet e avokatit konform tarifës së avokatëve, ashtu që shpenzimet për angazhimin e avokatit lidhur me procesin gjyqësor, padiësit të pare në emer te përpilimit të kërkesës se brendshme pranë të paditurës për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës t'ia shperblej shumen 624.00€ si dhe gjithashtu për shpënzimet gjatë procesit gjyqësor padiësve t'ua shperblej shpenzimet për taksën gjyqësore për padi shumën 101.00€, për taksën gjyqësore, të gjitha keto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes - pranimi ketij se ketij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbarrimit

III. REFUZOHET si e pabazuar e kërkesëpadiësi padiësve V. J., N. S., B. V., K. S. dhe Xh. G., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Av. B. P., me të cilën ka kërkuar që të "Detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, që padiësit të lartcekur në emer të shpenzimeve të shujtës ditore për periudhën prej datës 14.11.2018 deri me datë 23.02.2022, për 740 ditë pune, për secilin padiës dhe për secilin veç e veç nga të ia paguajë shumën prej 2.220.00€,

A r s y e t i m

Padiësi, përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate me datë 27.06.2021 ka parashtruar padi ndaj të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, pagës jubilarë dhe kompensimin e shujtës ditore, duke theksuar se i lartcekuri është në marrëdhënie të rregullt të punës tek e paditura që nga data 22.05.2000. Me nenin 29 par.2 të po këtij udhëzimi, padiësit i takon edhe një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, mirëpo e paditura për këto shpërblime për vitet 2018, 2019 2020 dhe nuk ia ka paguar padiësit. Ndërsa në bazë të nenin 29 par.1 të po të njëjtit UA, padiësit i takon edhe kompensimi për ushqimin – shujtën ditore, mirëpo e

paditura as këto shpenzimet të ushqimit dhe veshmbathjes deri më tani paditësit nuk ia ka paguar. Andaj, paditësi ka paraqitur padi ku ka kërkuar që të i kompensohet paga e 13-të për vitet 2018, 2019 2020 dhe 2021, shujta ditore për periudhën prej datës 14.11.2018 deri më 23.04.2022, I autorizuari i paditësit me parashtresën e datës 13.12.2022 e ka precizuar kërkesëpadinë, ashtu që në emër të shpërblimit të pagës së 13-të, ka kërkuar që të i kompensohet për vitet 2018, 2019 2020 dhe 2021,

Për paditësen V. J. (PK...), në emer të pagës se 13për secilin vit shuma prej nga 531.90€ euro, në emër të shujtës ditore shuma prej 2.220.00 euro si dhe pagën jubilarë në shumen prej 235.65 euro me kamatë ligjore si dhe shpenzimet procedurale, duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Për paditësin N. S. (SC...), në emer të pagës se 13për secilin vit shuma prej nga 359.21€ euro, në emër të shujtës ditore shuma prej 2.220.00 euro si dhe pagën jubilarë në shumen prej 142.00 euro me kamatë ligjore si dhe shpenzimet procedurale, duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Për paditësin B. V. (PK...), në emer të pagës se 13për secilin vit shuma prej nga 639.60€ euro, në emër të shujtës ditore shuma prej 2.20.00 euro si dhe pagën jubilarë në shumen prej 235.65 euro me kamatë ligjore si dhe shpenzimet procedurale, duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Për paditësin K. S. (SC...), në emer të pagës se 13për secilin vit shuma prej nga 418.70€ euro, në emër të shujtës ditore shuma prej 2.220.00 euro si dhe pagën jubilarë në shumen prej 142.00 euro me kamatë ligjore si dhe shpenzimet procedurale, duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Për paditësin Xh. G. (PK...) në emer të pagës se 13, për secilin vit shuma prej nga 667.26€ euro, në emër të shujtës ditore shuma prej 2.20.00 euro si dhe pagën jubilarë në shumen prej 235.65 euro me kamatë ligjore si dhe shpenzimet procedurale, duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

E paditura përmes përgjigjes në padi, ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar. Sa i përket kompensimit të pagës së 13-të, e ka kundërshtuar pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare, duke arsyetuar se Ministria e Financave nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë e kësaj çdo veprim apo nismë, duke përfshirë edhe nenin 29 pika 2 të Ua numër 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligimet financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së trembëdhjetë.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësin V. J., e ka filluar punën te e paditura nga data 25.06.2001 e lëshuar nga e paditura, dhe realizon pagë mujore në shumë prej 531.90€, paditësi N. S. e ka filluar punën te e paditura nga data 27.09.2004 vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, dhe realizon pagë mujore në shumë prej 359.21€, paditësi B. V., e ka filluar punën te e paditura nga data 25.06.2001 e lëshuar nga e paditura dhe realizon pagë mujore në shumë prej 639.60€, paditësi K. S., e ka filluar punën tek e paditura Nga data 27.09.2004 e lëshuar nga e paditura dhe realizon pagë mujore 418.70€, paditësi Xh. G. e ka filluar punën tek e paditura nga data 06.09.1999, e lëshuar nga e paditura dhe realizon pagë mujore 667.28€, Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve për vitin 2018, 2019 2020 dhe 2021. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Sa i përket kërkesës lidhur me kompensimin pagës së trembëdhjetë, gjykata gjen se në rastin konkret duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (tutje: UA nr.02/2018) i cili ka hy në fuqi me datë 18.11.2018, andaj me kujdes analizoi dispozitën e nenit 29 paragrafin 2 të këtij UA, ku është përcaktuar se “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.

Gjykata në këtë çështje kontestimore ka vërtetuar faktin se paditësi ka pasur vlerësim shkëlqyeshëm të performancës gjatë viteve 2018, 2019 2020 dhe 2021 dhe të njëjtit në këtë periudhë kohore nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, fakt i vërtetuar përmes formularëve të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve që gjenden në shkresat e lëndës. Për më tepër e paditura me anë të përgjigjes në padi nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje që do të vinte në dyshim performancën e paditësit për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj paditësit. Nga dispozita e lartcekur, rrjedh edhe e drejta e paditësit dhe detyrimi i të paditurës, që pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë dispozitë në fund të një viti kalendarik, paditësi të përfitojë si shpërblim një pagë mujore e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, andaj gjykata pasi vërtetoi edhe lartësinë e pagës mujore të paditësit përmes Vërtetimit të punësimit me numër të referencës 07/1-01SAP-P/3049 i lëshuar nga e paditura me datë 15.04.2021, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së ku parashihet që “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Pretendimin e të paditurës dhënë në përgjigje në padi se nuk ka mjete financiare për kompensimin e këtij shpërblimi, gjykata i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme dhe i vlerëson si të parëndësishme për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestuese, pasi që paditësi nuk është përgjegjës për planifikimin e buxhetit për obligimet që dalin nga UA nr.02/2018, andaj edhe rrethanat subjektive të të paditurës lidhur me mos planifikimin me kohë të buxhetit për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ nuk e liron të njëjtën nga detyrimi për pagesën e këtyre shpenzimeve.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Gjykata vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, meqenëse janë plotësuar kushtet e parapara me nenin 399 par.1 të LPK-së, ku është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura” dhe atë për arsyet si në vijim :

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, pas precizimit të padisë ka kërkuar që të i njihet kompensimi i shpenzimeve të shujtës ditore, gjykata të njëjtat kërkesa i refuzoi në tërësi, pasi që me kujdes analizoi nenin 29 par.1 të UA nr.02/2018, ku është përcaktuar se “Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, kjo dispozitë nuk e detyron shprehimisht të paditurën në kompensimin e shujtave ditore, por është dispozitë që përcakton kushtet e përgjithshme për përcaktimin e pagës bazë dhe shtesave, e që këto kushte konsistojnë në vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës. Po ashtu, bazuar edhe në nenin 47 par.4 të Ligjit për Policinë numër 04/L-076 është përcaktuar se “Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj.”, e në rastin konkret gjykata nuk gjeti se kompensimi për shujta dhe veshmbathje është i përcaktuar shprehimisht me ligj, pra nuk ka ndonjë dispozitë të karakterit obligativ dhe gjithashtu nuk gjeti se në mes të palëve ndërgjyqëse ekziston ndonjë raport kontraktual që do ta detyronte të paditurën në kompensimin e shujtave ditore dhe veshmbathjes për paditësin, për çka rrjedhimisht gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën I të dispozitivit, gjykata e morri sipas nenit 449 dhe 452 par.2 të LPK-së, duke pasur parasysh suksesin në procedurë, me ç’rast paditësit iu pranua shumat e shpenzimeve në vlerë prej 104.00€ dhe atë për përpilimin e padisë, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës dhe në emër të taksës gjyqësore shumë prej 20.00€.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.6980/21, datë 07.03.2024

Gjyqtarja
Përparim Zeka

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.